



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bashkim Ramosaj, Kryetar i Komunës së Deçanit Hajdar Sutaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Deçanit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL	Datë: 16.01.2025 Nr. 020-32
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Donjeta Cakolli, Zyrtares e Lartë për Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Deçanit	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Deçanit	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet baze dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.XI-3 për miratimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025

I miratuar më datë: 30.12.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 16.01.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024, ka miratuar vendimin Nr.XI-3 për miratimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025.

MAPL konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Deçanit, është bazuar në nenin 12, paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe neni 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 13 i Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 6 paragrafi 1 i Rregullorës (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimi është miratuar në seancën e XI-të të Kuvendit të Komunës së Deçanit e mbajtur me dt.30.12.2024, është miratuar me 20 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Bashkim Ramosaj, gradonačelnik opštine Dečan Hajdar Sutaj, predsedavajući Skupštine opštine Dečan	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erbllin Hietemi, direktor Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana, 16.01.2025 br. 020-32
Službenik-ca utvrđivanje procene:	za pravne Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu procenelgijor	pravne Donjeta Cakolli, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Dečan	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Dečan	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka br.XI-3 o usvajanju opšte liste nepokretnih imovina opštine i posebne liste opštinskih imovina koje se planiraju za davanje na korišćenje tokom 2025. godine
Usvojena dana, 30.12.2024.
Podnošena na razmatranje u MALS-u dana, 16.01.2025.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi. Dok što se tiče sadržaja akta i obaveza prema drugim srankama su u nadležnosti opštine.

Obrazloženje

Skupština opštine Dečan, na sednici održanoj dana, 30.12.2024. godine, usvojila **Odluku br.XI-3 o usvajanju opšte liste nepokretnih imovina opštine i posebne liste opštinskih imovina koje se planiraju za davanje na korišćenje tokom 2025. godine.**

MAIS, konstatuje da je akt koji je usvojila Skupština opštine Dečane zasnovan na članu 12. stav 1. i 2. Slovo(d), i članu 14. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 13. Zakona br. 06/L-092, o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 6 stav 1 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupaka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine. Odluka je usvojena na IX-oj sednici Skupštine opštine Dečane održanoj dana 30.12.2024.godine, sa 20 glasova "za", 0 "protiv" i 0 "uzdržanih".

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ustaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.